

GUIDË

MBI DEKLARIMIN E PASURIVE DHE PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Pas amendimeve të reflektuara në ligjin 45/2014 dhe 46/2014



ILDKPKI

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARTIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Ky publikim u përgatit me mbështetjen e



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim
në Evropë. Prezenca në Shqipëri



GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG
Ministère des Affaires étrangères

Refuzim:

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Tiranë, Korrik 2014



RISITË E NDRYSHIMEVE LIGJORE NË LIGJIN E DEKLARIMIT TË PASURIVE

- Saktësimi i listës së subjekteve deklarues.
- Shtimi i zërit “shpenzime të deklarueshme” si objekt deklarimi.
- Forcimi i kontrollit ndaj personave të lidhur.
- Britja e vlerës së masave administrative me gjobë

SUBJEKTET QË MBARTIN DETYRIM PËR DEKLARIM TË INTERESAVE PRIVATE:

- Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat;
- Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
- nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil;
- prefektët, nënprefektet, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive, të njëjse bashkiake dhe të komunave;
- drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror;
- prokurorët, gjyqtarët dhe përmbauesit e të gjitha niveleve;
- drejtuesit e institucioneve të pavarura publike dhe anëtarët e enteve rregullatore;
- drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve, (komisariateve) në qendër, rrethe e rajone, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe asaj të Doganave dhe nivelet drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;



- zyrtari i administratës doganore dhe tatimore, që merret me mbledhjen e të ardhurave doganore ose tatimore;
- drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e kompensimit të pronave, të privatizimit dhe regjistrimit të pasurisë,
- zyrtarët, që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta;
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj.
- drejtuesit e institucioneve publike në varësi të institucioneve qendrore në nivel qarku*;
- drejtuesit e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe me më shumë se 50 punëtorë.
- personat që sipas nenit 9 të këtij ligji mbartin detyrimin e deklarimit me kërkesë.
- funksione të tjera të paparashikuara në këtë ligj kur merret vendim nga Kuvendi

**Në listën e subjekteve deklarues shtohet dhe një kategori e re subjektesh "drejtuesit e institucioneve publike në varësi të institucioneve qendrore në nivel qarku" të cilët mbartin detyrim për deklarim periodik të interesave private në Inspektoratin e Lartë.*

Interesat private të deklarueshme përfshijnë:

- Të drejtat dhe detyrimet pasurore të çdo lloji natyre,
- Çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile,
- Dhurata, premtime, favore dhe trajtime preferenciale,
- Sendet me vlerë të vecantë mbi 300 000 (treqindmijë) lekë,
- Negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit,
- Angazhime në veprimtari private,



- Interesa private të subjektit që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës,
- Çdo shpenzim i deklarueshëm* me vlerë mbi 300 000 (treqindmijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

**Shpenzim i deklarueshëm, do të konsiderohet tërësia monetare e paguar, për arsim , mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji të kryera nga subjekti deklarues, (apo personi i lidhur).*

Në amendimet e ligjit nr. 9049 datë 10.4.2003 , në nenin 4/1 është përcaktuar se:

Të gjithë zyrtarët, të cilët për shkak të funksionit publik që kryejnë, bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklarin për herë të parë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në CASH jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion Lekë.

Për zyrtarët që deklarojnë për herë të parë, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve CASH mbi vlerën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Subjekt i deklarimit të interesave private me kërkesë :

Inspektori i Përgjithshëm ka detyrimin të kërkojë deklarin e pasurive e të interesave private dhe burimet e krijimit të tyre, sipas kërkesave të këtij ligji, për individët ose personat fizikë e juridikë, kur, rezulton se këta të fundit janë persona të lidhur me subjektet që mbartin detyrimin për deklarim periodik.

Vlerësohet person i lidhur në zbatim të paragrafit të mësipërm edhe :

- **i besuari**, sipas kuptimit të neneve 3 pika 6 dhe 38 pika 3 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005
- **bashkëjetuesi**, sipas kuptimit të neneve 163 e 164 të ligjit nr.9062, date 8.5.2003 “Kodi i Familjes”.



Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar mbartin detyrim për deklarim dhe personat e lidhur me zyrtarin: bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore.

Përgjegjësia ligjore e personit të lidhur mbi vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara.

- Kur pasuria e personave të lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore) është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo person i lidhur me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- “Anëtar i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara.”

**Ky ndryshim ligjor vjen si rrjedhojë e ndryshimeve të bëra nga ligjvënësi në nenin 257/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se:*

“Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.

Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”.

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet :

- *Për mosdeklarim periodik apo me kërkesë, gjobë nga 50 000 lekë - 100 000 lekë;*
- *Për moslëshim autorizimi, gjobë nga 30 000 - 50 000 lekë;*



- Kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë, gjobë 50 000 lekë - 100 000 lekë.
- Për shkelje të ligjit nga ekspertët vlerësues, gjobë nga 100 000 lekë - 200 000 lekë;
- Për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, gjobë nga 50 000 lekë - 100 000 lekë;

RISITË E LIGJIT MBI PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE

- Shtimi i rrethit të zyrtarëve, që iu ndalohet të përfitojnë nga kontratat me palë një institucion publik.
- Forcimi i kufizimeve të interesave private për drejtuesit e qeverisjes vendore, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave.
- Saktësimi i procedurës për parandalimin e konfliktit të interesave në organet kolegjiale.
- Rritja e kompetencave të ILDKPKI-së në drejtim të parandalimit dhe ndëshkimit të rasteve të konfliktit të interesave.
- Aplikimi i masave shtrënguese për zyrtarët të cilët kanë ushtruar këtë veprimtari në kushtet e konfliktit të interesave.

Ndalimi i lidhjes së kontratave (neni 21):

Ligji ka përcaktuar ndalimin për zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, në lidhjen e kontratave me palë një institucion publik për shkak të funksionit, përgjegjësive e kompetencave të tyre.

- Zyrtarët e përfshirë në ndalim (funksionarë të lartë publikë, nënpunës të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, gjyqtarë dhe prokurorë të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit) dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky



zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të përfitojnë fonde publike të prokuruar nga asnjë institucion publik qëndror apo vendor, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Ndalimi absolut shtrihet në të gjitha llojet e kontratave dhe nënkontratave si: Prokurimi publik i ndërtimeve, mallrave apo shërbimeve, shitja, shkëmbimi, qiraja/emfiteoza, dhurimi, furnizimi, sipërmarrja, transporti etj, *(përveç kontratave të parashikuara në nenin 21/5).*
- Për zyrtarët e qeverisjes vendore, *(kryetarit, nënkryetarit të bashkisë/komunës/këshillit të qarkut, kryetarit të këshillit përkatës, ose zyrtar i nivelit të lartë drejtues të qeverisjes vendore)* ndalimi në lidhjen e kontratave për këta zyrtarë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron funksionin.
- *Me amendimet ligjore, janë përfshirë në kufizimin absolut të lidhjes së kontratave apo nënkontratave edhe gjqqtarët dhe prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e atë të apelit, ashtu dhe personat e lidhur me ta.*
- *Rrethi i personave të lidhur në zbatim të ndalimit të “lidhjes së kontratave” përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es bashkëjetuesit/es.*

Zyrtarëve të tjerë të **papërfshirë** më lart, ju ndalohe lidhja e kontratave, në rastet kur kanë kompetencë thelbësore në vendimarrje dhe kanë interes privat të tillë që mund të bëhet shkak për lindjen e konfliktit të interesit.

MASAT QË DUHET TË MARRË ZYRTARI PËR SHMANGIEN E KONFLIKTIT TË INTERESIT:

Zyrtari në ushtrimin e funksioneve publike ka detyrimin të zgjidhë vetë çdo situatë të konfliktit të interesave, duke përdorur një ose disa nga mënyrat:



- É Transferim ose tjetërsim i interesave private
- É Vetpërrjashtim nga procesi konkret i vendimarrjes ose
- Në rastet e organit kolegjial, duke mos marrë pjesë në diskutimin dhe në votimin e çështjes në konflikt.
- É Dorëheqje nga angazhimet, detyrat private;
- É Dorëheqje nga funksioni publik;
- É Njoftimi i eprorit dhe provimi e dokumentimi i zgjidhjes së konfliktit të interesit

Zyrtari nuk çlirohet nga përgjegjësia e rënies në konflikt interesi, kur masat e marra nga vet ai nuk rezultojnë të frytshme në parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit.

Çdo shkelje e dispozitave mbi shmangien e konfliktit të interesave përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

Rëgullimi i pasojave juridike të akteve të nxjerra në kushtet e konfliktit të interesit”.

Inspektorati i Lartë ka kompetencë për marrjen e nismës për shpalljen e pavlefshmërisë në rrugë administrative të akteve dhe kontratave administrative, shfuqizimit apo revokimit të tyre nga organet kompetente.

- Dënohet subjekti/zyrtari, i ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit.
- Goditet akti/kontrata në kushtet e konfliktit të interesit.
- Kalimi i barrës së dëmshpërblimit zyrtarit që ka vepruar me keqbesim.

Krahas masave disiplinore dhe administrative të marra ndaj subjektit i cili ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke marrë një vendim në kushtet e konfliktit të interesit, instrument i rëndësishëm është dhe shfuqizimi/revokimi i aktit apo kontratës administrative të nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit

Kundravajtjet administrative dhe sanksionet

- Për mosvetëdeklarim apo për mosdeklarim me kërkesë, gjobë nga 30 000 lekë -50 000 lekë;



- *Për moslëshim autorizimi, gjobë nga 30 000 -50 000 lekë;*
- *Për shkelje të ndalimit absolutë në lidhjen e kontratave marrjen e dhuratave, apo sigurimi i të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë, gjobë 100 000 lekë -200 000 lekë;*
- *Për shkelje të dispozitave mbi parandalimin e konfliktit rast për rast të interesave, gjobë nga 100 000 lekë -300 000 lekë;*
- *Për shkelje të dispozitave mbi parandalimin e konfliktit të vazhdueshëm të interesave, gjobë nga 300 000 lekë -500 000 lekë;*
- *kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, gjobë nga 50 000 lekë -100 000 lekë.*



Ju mund të merrni informacion shtesë edhe nëpërmjet faqes së internetit: www.hidaa.gov.al

duke shkruar në:

info@hidaa.gov.al

ose mund të merrni kontakt me Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit:

Tel: 042 259 461

BASHKËPUNO ME ILDKPKI

Denonconi në numrin pa pagesë

0800-9999 

Kontakttoni:

unedenoncoj@hidaa.gov.al

